



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2019

**Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion**

E.mail: \_\_\_\_\_

Në vijim të kërkesës suaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me anë të postës elektronike dhe rregjistruar me nr.10539 prot, datë 19.06.2019, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit”, ku kërkon informacion lidhur me kompetencat dhe funksionet e Bashkisë Shkodër lidhur me ndërtimin dhe administrimin e banesave sociale, ju sqarojmë si më poshtë:

Spektori i Strehimit Social është pjesë e Drejtorisë së Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Baza ligjore me anë të cilit vepron Bashkia Shkodër në fushën e strehimit është Ligji nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, dhe aktet nënligjore, ku përcaktohen kompetencat dhe funksionet e Bashkisë në fushën e Strehimit social:

- Bashkia është përgjegjëse për zbatimin e politikave të strehimit sipas programeve të përcaktuara në këtë ligj.
- Identifikon nevojat për strehim në gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.
- Evidenton sheshet e ndërtimit dhe përgadit listën e tyre, në zbatim të programeve të strehimit të përcaktuara në këtë ligj.
- Krijon bazën e të dhënave, në nivel vendor, për aplikimet e bëra për programet sociale të strehimit.
- Bashkia harton planin e veprimit dhe projekt buxhetin përkatës për zbatimin e programve afatgjata të strehimit.
- Harton projekte për përmirësimin e kushteve të banimit dhe aplikon për fonde pranë ministrisë së linjës apo donator.

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**